

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
Nr. 2985 Rep.



## **KONTRATE SHITJE KUOTASH**

Sot me date 07.07.2003 (dymije e tre), para meje noterit u paraqiten personalisht :  
SHITESI: **Sokol Beshaj**, i biri i Fatmirit, i datl. 01.11.1957, lindur ne Fier e banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, Ortak ne masen 50 % i shoqerise **"INA"** sh.p.k.

BLERESI: **Ferdinand Caushi**, i biri i Faikut, i datl. 05.07.1968, lindur ne Tepelene e banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, Ortak ne masen 50 % i shoqerise **"INA"** sh.p.k.

Ne mbeshtetje te dispozitave ligjore eshte krijuar Shoqeria **"INA"** Sh.p.k, me vendimin Nr. 12602 date 26.10.1995, me qender ne Qytetin e Tiranës, me kapital themeltar 100.000 lek, me kohezgjatje 10 vjet, me objekt te veprimtarise ne fushen e ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore, punime restaurimi, dhe ne pergjithesi te gjitha llojet e konstruksioneve te inxhinjerise civile ne Shqiperi dhe jashte shtetit, drejtimi dhe administrimi i pasurive te patundshme dhe per llogari te te treteve, blerje e trojeve per te perdorur per ndertime per qytete e fshatra e per te shitur keto ndertime edhe si pjese te vecanta, tregtimi ne pergjithesi i pasurive te patundshme, mirembajtja e çdo lloj vepre ose pasurie te patundshme, blerje e shitje me shumice dhe pakice te materjaleve te ndertimit brenda dhe jashte vendit, prodhime te materjaleve te ndertimit, me administrator Aleksander Mitrushi. Me vendimin nr. 12602/1 dt. 14.01.1999 eshte vendosur largimi i z.Aleksander Mitrushi dhe shoqeria ka kaluar ne shoqeri me dy ortake dhe administratore qe jane Sokol Beshaj dhe Ferdinand Caushi. Me vendimin nr. 12602/2 dt. 15.01.1999 eshte vendosur shtimi i objektit te veprimtarise se shoqerise.

Shitesi Sokol Beshaj eshte zoterues ne masen 50 % te kuotave ne shoqerine **"INA"** sh.p.k. me vlere nominale 50.000 leke.

Me vendimin Nr.3 date 07.07.2003 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise **"INA"** sh.p.k. eshte vendosur shitja prej 50% te kuotave nga ortaku Sokol Beshaj dhe blerja e ketyre kuotave nga ortaku tjeter Ferdinand Caushi i cili behet ortak i vetem dhe administrator i shoqerise **"INA"** sh.p.k. me 100 % te kuotave me vlere 10.000 leke.

Nga ana e tij bleresi Ferdinand Caushi deklaroi se eshte dakort qe te bleje kuotat nga shitesi dhe se i ka paguar atij vleren nominale 50.000 leke. Shitesi deklaroi se e ka marre kete shume dhe zhvishet nga pronesia mbi shoqerine duke mos patur me asnje te drejte mbi te.

Kontrata e shitblerjes u redaktua konform nenit 705 e vijues te Kodit Civil si dhe konform nenit 47 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe


konform vullnetit te lire dhe te plote te paleve, te cilet pasi lexuan permbajtjen e aktit, e nenshkruan si me poshte.

Une noteri verifikova identitetin e paleve, u lexua me ze te larte akti noterial dhe pasi e gjeta konform vullnetit te tyre e vertetoj si me poshte.

**PALET**

**SHITESI**

**Sokol Beshaj**

Sokol Beshaj  


**BLERESI**

**Ferdinand Caushi**

Ferdinand Caushi  


**NOTERI**

**Nezir Murati**

